



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

Viti shkollor 2012/2013

TESTI 3

GJUHË SHQIPE

UDHËZIM PËR PUNË

- Testin të cilin duhet ta plotësosh i ka 20 detyra, kurse për zgjidhjen e tyre janë paraparë 120 minuta.
- Lexo me kujdes çdo detyrë, në fillim dhe mendo për këtë se çfarë kërkohet në të. Gjej mënyrën e zgjidhjes së saj (duke rrethuar, lidhur, nënvizuara, përshkruar etj.).
- Në detyrat, në të cilat nga ti kërkohet të shkruash diçka, gjithmonë përdor emërtimet e plota; shkurtesat nuk janë të lejuara (psh. Duhet të shkruhet emër e jo em., kallëzore e jo kall. apo diçka ngjashëm).
- Testin duhet ta plotësosh me **stilolaps**. Gjatë punës mund të përdorësh lapsin grafit dhe gomën. Para se të dorëzosh testin, verifiko përgjigjet tuaja edhe njëherë, e pastaj të gjitha përgjigjet shkruaji me stilolaps. Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps grafit nuk pranohet, por as përgjigjja të cilës i është hequr vizë dhe e cila është korrigjuar me laps kimik.
- Në katrorin, i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës, mos shkruaj asgjë. Kjo është hapsira ku kontrolluesi shkruan numrin e poenëve. Në këtë hapsirë dhe në faqen e fundit gjithashtu mos shkruaj asgjë.
- Nëse zgjidhjen e detyrave e mbaron më herët, dorëzo testin dhe ngadalë largohu pa i penguar të tjerët.

Të dëshirojmë sukses në provim!

- 1.** Ishte viti 1897, unë atëherë isha 15 vjeç, kur takova Shekspirin për herë të parë. Kjo ishte një nga ngjarjet më të mëdha të jetës sime. Atëherë studioja në një gjimnaz grek. Megjithëse me prejardhje shqiptare, më duhej të shkoja në një shkollë greke në Adrianopojë, pasi shkollat shqipe nuk i lejonte qeveria turke...

Më thanë në mund t'i zija vendin e aktorit kryesor dhe të luaja Hamletin. Pranova menjëherë, para se t'u kthehej mendja. Puna u ngatërrua kur u menduan të gjenin dikë për të luajtur Ofelinë. Vetëm një njeri mbahej ende në këmbë. Kjo ishte Kaliroi. Ishte e çalë dhe kurrë s'kish dalë në skenë, madje as me ndonjë rol të vogël...

Lexo tekstin e lartshënuar dhe trego se cilit lloj të tekstit i takon:

1.

- a) Tekst historik
- b) Tekst autobiografik
- c) Tekst joletrar

2. Teksti jep informacione për jetën e shkrimtarit:

- a) Fan S. Noli;
- b) Naim Frahëri;
- c) Migjenit.

- 2.** Janë dhëne dy shpjegime. Rretho shkronjën para përgjigjes në të cilën bëhet fjalë për argumentim:

- a) Nënndarje e një kapitulli, e një ligji etj., që fillon me kryeradhë dhe me një shenjë të posaçme.
- b) Paraqet argumente për një çështje, vërteton me argumente, sjell prova.
- c) Pjese e një teksti të shkruar, që përfshin fjalitë nga njëra kryeradhë tek tjetra dhe që shpreh një mendim pak a shume të plotë e të pavarur;

- 3.** Blina mbron gjyshen frikacake

Binte shi, nata afrohej, kurse shiu s'di të ndalet. Dhoma e Blinës është mjaft e ngrohtë, sepse aty fle edhe gjyshja e saj.

Vogëlushes i dhimbet macja të cilën gjyshja do ta nxirrte përjashta. Blina mori macen dhe e futi nën jorgan. Erdhi gjyshja e puthi vogëlushen dhe i dëshiroi gjumë të ëmbël.

Diku në mesnatë macja nisi të gërhasë dhe padashur gjyshes i preki këmba në turirin e maces.

- Blina, përse e prure këtu macen, - bërtiti gjyshja. Vogëlushja e molisur i tha:
- Gjyshe, mora vesh se sonte do të vij në minjtë, prandaj për atë arsye edhe e mora.

Gjyshja vuri buzën në gaz dhe ra të flejë.

Lexo tekstin e lartshënuar dhe trego se çfarë teksti është:

- a) Tekst informative
- b) Tregim për fëmijë
- c) Novelë

4. Anila i tha Tuanës:

- Nuk e boj unë mo. Nuk e du njerkën.Nuk e du,nuk e du.
- E zeza un, - tha Tuana. Kam tut prej njerkës. Kisha tut edhe un, që isha e madhe.

Lexo tekstin e lartshënuar dhe të njëjtin shkruaje në gjuhën letrare.

5. Hymni I flamurit (F.S.Noli)

a) O flamur gjak, o flamur shkabë

O vend e vatër,o nënë e babë,
Lagur me lot,djegur me flake
Flamur I kuq,flamur I zi.

b) Fortesë shkëmbi,tmerr tirani,

S'të tremb Romani, as Venecjani,
As sërp Dushani, as Turk Sulltani
Flamur i madh për vegjëli

c) Flamur që lind Shën Konstantimin

Pajton Islamin e Krishterimin
Çmall midis feve e vllazënimim
Flamur bujar për njerëzi.

Lexo poezinë me kujdes dhe trego se cila strofë a), b) apo c) tregon dëshmi historike, kulturore dhe politike.

- 6.** a) Shkruani fonemat zanore te fjalët: përparësi,bashkëpunëtor,gurëgdhendës,përballoj.
b) Shkruani fonemat bashkëtingëllore te fjalët: mendim, provoj televizor, gëtar, vendosi.

7. O TOKË,O QIELL,SHIKONI SE Ç'PO PËSOJ NGA PERËNDITË! SHIHNI SE SI DO TË HEQ E DO TË VUAJ PËR SHEKUJ ME RRADHË ! KUR VALLË DO TË MARRIN FUND KËTO MUNDIMET E MIA?...

Lexo tekstin e lartshënuar dhe të njëjtin shkruaje me shkronja të dorës(shkrimi).

- 8.** Në tekstin e dhënë më poshtë përmirëso gabimet gjuhësore duke i respektuar rregullat drejtshkrimore;
“Githnji m’ka pelqy fudballi por ndeshja e zhvillueme te dillen isht shum terheqse. Si skuadra jon ashtu e

9. Në Bujanoc janë investuar mbi 25 milion euro.

- Në klikimin e rregullt me qytetarë, kryetari i komunës së Bujanocit, ka bërë të ditur se sivjet në mbi 130 projekte nga buxheti i komunës dhe ai qeveritar, por edhe donacionet e tjera në komunën tonë janë investuar mbi 2.5 milion euro.

Qytetarët që morën pjesë në këtë takim kanë kërkuar nga zyrtarët komunal që në të ardhmen të bëhen edhe më shumë investime në përmirësimin e kushteve të jetesës. Pati edhe kërkesa tjera të pjesëmarrësve në këtë debat...

1. Teksti i lartshënuar i takon:

- a) Raportit
- b) Referatit
- c) Lajmit

2. Është tekst:

- a) letrar;
- b) joletrar.

10. - At çastë të dy djelmoshat e ndjenë vetën të pa fuqishëm. Selimi kputi meniher një thupër të gjat dhe e vringlloi nëpër këmbët e dhenve që ti shpejtonin hapat dhe që ti hiqnin turinjt e pa ngopur nga bari i njom dhe i pa shkelur.

Lexo tekstin e lartshënuar dhe përmirëso gabimet drejtshkrimore.

11. Ndaji fjalët në rrokje.

- kodra, kokrra, kushti, lavdi, ekskursion, thembra, shufra, lundra, qendra.

12. Në fjalitë e mëposhtme, duke nënvizuar, përcaktoni fjalën e theksuar të fjalisë;

- 1. Të gjithë mirë mbërritën?- pyeti Artani.
- 2. Jepjani Altinit paratë.
- 3. Genci erdhi pardje në shtëpi.

13. Në fjalët e mëposhtme:

1) Nënvizu rrënjën:

Punoj, punim, i papunë, punëtor, punësoj, përpunoj

2) dallo parashtesën:

Padrejtësi _____

Zhvendosje _____

Nëntokësor _____

14. 1. Gjuha është simboli ynë kombëtar.

2. Këngët e vendit tim janë të bukura.

Lexo fjalitë e lartshënuara, nënvizo kallëzuesorin e kryefjalës dhe trego me çfarë është i shprehur.

15. Trego kuptimin e shprehjeve frazeologjike.

1.-shes mend _____

2.-i bëj bisht _____

3.-var buzët _____

4. -daulle e shpuar _____

5. -pendë pule _____

6.- fill e për pe _____

16. Detyra:lidhi titujt e veprave letrare me emrat e autorëve.

1.Rexhep Hoxha. _____

2.Bedri Dedja _____

3.Maksut Shehu _____

4.Naim Frashëri _____

5.Sulejman Pitarka _____

6.Qamil Batalli _____

17. Para vetes i ke dy vjersha te shkruara ne dy krijimtari letrare. Cila prej tyre i takon asaj gojore?

a) - Ç'ke, o flamur, që s'valon?

- Jam sëmure e po rënkoj,

jam goditur brinjë më brinjë,

që kur sollën Italinë...”

b) “Toke e dashur,

Ti diçka ke kërkuar nga unë.

“Ndryshomë, o bir” – me ke thirrur nga grykat e maleve.

Rretho shkronjën para përgjigjes se saktë:

18. - Romani për fëmijë „Sarajet e bardha” nga shkrimtari Vehbi Kikaj është botuar më:

- a) 1954
- b) 1967
- c) 1971

19. „O Dërvish,O Dërvish! A do pite, a do mish.”

Lexo fjalinë e lartshënuar dhe gjeje emrin e veprës dhe emrin e autorit. (Kjo vepër është skenar edhe për film).

- a) Udhëtimi i shigjetës së kaltër
- b) Lepuri me pesë këmbë
- c) Nipi i minatorit

20. Lexo tekstin e poshtëshënuar dhe gjeje titullin e veprës dhe emrin e autorit.

Shkrimtari në këtë vepër na paraqet gjendjen e vështirë të popullit shqipëtarë gjatë kohës së Skënderbeut.

Autori dramën e ka thurur rreth tradhtisë së Moisi Golemit si princ e luftëtarë dhe tragjedië familjare të mjeshtër të shpatës Palush Dibrës.

Personazhe tjerë në këtë vepër janë: Gjergj Kastrioti, Lek Dugagjini, Sulltan Mehmeti, Mirushja, Zoga etj.

1. Vepra është:

- a) Historia e Skënderbeut (Naim Frashëri)
- b) Trimi i mire me shokë shumë (Sulejman Pitarka)
- c) Gjenerali i ushtrisë së vdekur (Ismail Kadare)

2. Vepra është:

- a) Përmbledhje me poezi;
- b) Roman historik;
- c) Dramë.

Rezultati në testin e gjuhës shqipe

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!
Këtë faqe e plotëson Komisioni!

Numri i përgjithshëm i pikave

		,	
--	--	---	--

Komisioni:

- _____
- _____
- _____
- _____

Numri i pikave për secilën detyrë.

Numri i detyrës	E pplotësuar	0 pika	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Shkruaj ✕ në vendin përkatës.

Numri i identifikimit (Shifra e nxënësit)	
Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	